

POZITIVITETI

HYRJE

Me realizimin e kësaj porosie arrijmë të planprogrami hyjnor i Allahut në ndryshimin, përmirësimin dhe rezultatin se: “Vërtetë Allahu asnjëherë nuk e ndryshon gjendjen e një populli pa e ndryshuar ai popull gjithçka ka në veten e tij.” Është mëkat i madh dhe punë shumë e shëmtuar negativiteti dhe mos angazhimi i shoqërisë në asgjësimin e saj, humbja e pozitivetit dhe mosinteresimi për çështjet që e rrethojnë.

Duhet të angazhohemi në shërimin nga të këqijat, nga gabimet dhe ato t’i zëvendësojmë me pozitivet dhe përkujdesje për gjërat që na rrethojnë neve dhe shoqërinë në përgjithësi.

Lus Allahun xh.sh. që të më bëjë dobi mua dhe lexuesve ky fjalim, po ashtu lus Allahun xh.sh. që këtë fjalim ta bëjë rrugë në drejtim të pozitivetit për gjithë shoqërinë dhe të gjithë muslimanët. Ta bëj angazhim drejt përmirësimit dhe ndryshimit të gjendjes së mjerueshme momentale në gjendje pozitive në të cilën marrin pjesë të gjithë pjesëtarët e shoqërisë.

Kuptohet, me vendosmëri, me shpresë dhe bindje për dritën e së nesërme, për lumturinë, ngritjen, zhvillimin, triumfin dhe qeverisjen e Islamit dhe të muslimanëve.

Padyshim, Allahu i Lartmadhëruar ka mundësi për këtë. Atë e kemi ndihmëtarin dhe mbrojtësin më të mirë, nuk ka mbrojtës dhe ndihmëtar më të mirë se Ai.

LLOJE TË NEGATIVITETIT DHE JO POZITIVITETIT

Kam për qëllim të gjitha llojet e negativitetit në shoqëri, duke filluar prej prishjes së ashensorit dhe moskujdesjes së disa pjesëtarëve të shoqërisë në rregullimin e tij, mosmbyllja e kapakut të tualetit dhe mospërkujdesja e të gjitha çështjeve tjera banesore të përbashkëta.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Secili thotë: Nuk është çështja ime. Kjo nuk më intereson, nuk kam të bëjë me këtë. Pastaj, në punë shohim të meta të panumërta, duke i lënë shumë çështje pas dore, e deri te vjedhja, shohim moskujdes për të tjerët..

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Secili thotë: Nuk është punë e imja, kjo nuk më intereson, nuk kam të bëj me këtë, nuk është në kompetencën time.

A mund ta imagjinosh se sa është e përhapur kjo dukuri dhe sa është e dëmshme dhe negative?

Hyn në automjet ku është ambient i vogël, kur i sheh se si të tjerët menjëherë e ndezin cigaren, pa u interesuar dhe pa u brengosur se a i dëmton të tjerët apo jo.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Secili thotë: Nuk është punë e imja, kjo nuk më intereson, nuk kam të bëj me këtë, aq shumë është përhapur dukuria negative në këto çështje, sa që është bërë çështje normale edhe pse është e shëmtuar.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Si është e mundur që Allahu t’na ndihmoj derisa ne jemi në këtë gjendje dhe veprojme kështu?!

Shohim se si rinia është e pamoralshme dhe e kanë humbur karakterin, janë larguar nga rruga e Zotit të tyre, djem e vajza, burra e gra.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Secili thotë: Nuk kam të bëj me këtë, nuk është punë e imja, kjo nuk më intereson, nuk kam të bëj me këtë, nuk është në kompetencën time.

E shohim se si Muezini e thërret ezanin ndërsa pjesa më e madhe nuk i përgjigjen thirrjes.

Shohim kafenetë dhe klubet të mbushura me njerëz, ndërsa xhamitë jo, përpos disave që falen.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Secili thotë: Nuk kam të bëj me këtë, nuk është punë e imja, kjo nuk më intereson, nuk kam të bëj me këtë, nuk është në kompetencën time.

Shohim se si në Palestinë vriten, priten, dëbohen, malltretohen; po ashtu në Irak, ndërsa rinia e muslimanëve të zhytur në epshe, kënaqësi, dëfrime; të zhytur në këngë, filma, seriale. Nuk shohim këshilltarë përpos një numri të vogël, të cilët i ka mëshiruar Allahu dhe i ka udhëzuar.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Secili thotë: Nuk kam të bëj me këtë; nuk është punë e imja, nuk jam kompetent për këtë.

Kjo dukuri negative e ka mbuluar në tërësi jetën tonë, sa që edhe të vegjlit rriten e kultivohen në këtë dukuri.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Ne nuk i trimërojmë fëmijët tanë me pozitivitetin me të cilin janë lindur, por i zhytim në dukuri negative, i bëjmë të mendojnë negativisht ashtu siç jemi ne!

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Si mund të ndryshoj pozitivisht gjendja e umetit derisa të jemi kështu në këtë dukuri negative dhe mosinteresimi për gjendjen aktuale?!

Si mund të arrijmë deri te fitorja kur ne nuk veprojmë për realizimin e saj?!

Duhet që negativitetin ta shndërrojmë në pozitivitet.

POZITIVITETI ËSHTË PROGRAM I ZOTIT

Pse i gjithë ky negativiteti?

Sepse të gjithë ne themi me një gjuhë të përbashkët:

“Mendimi im nuk është në gjendje për ta ndryshuar në të mirë dhe për ta rregulluar gjendjen.”

Vëlla!!

Patjetër ti duhet të jesh pozitiv, edhe pse asgjë nuk ndryshon rreth teje. Ti patjetër duhet të këshillosh, të udhëzosh dhe të kumtosh të vërtetën, ndërsa ndryshimin e gjendjes e bënë i Gjithëfuqishmi, Allahu i Lartmadhëruar.

Vërtet Allahu i Lartmadhëruar nuk do asgjë tjetër, përpos angazhim dhe shtytje për përmirësimin e gjendjes në vetvete dhe atë çka të rrethon, por me sinqeritet, durim dhe bindje të plotë në Allahun e Lartmadhëruar.

Vërtet Allahu i Lartmadhëruar na shpërblen për angazhimin dhe rrethanat, të cilat mundohemi t'i ndryshojmë në të mirë, e jo për rezultatet e tyre.

Vëlla!!

Pozitiviteti është program hyjnor i Allahut, program i adhurimit, program i thirrjes, e cila ndikon dhe bën dobi, për këtë arsye duhet të jesh pozitiv në vetvete aty ku jeton, që të jesh i devotshëm dhe të largohesh prej gabimeve, po ashtu duhet të jesh pozitiv me të tjerët, nuk është në rregull që vetëm veten ta ndryshosh e pastaj me menduar se aty u rregullua dhe ka përfunduar çdo gjë.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Vërtet Allahu nuk e ndryshon (pozitivisht) gjendjen e një populli, derisa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre.” (Erraëd 11). Nuk ka thënë se Zoti e ndryshon njeriun pa e ndryshua ai çka ka në veten e tij, edhe pse ndryshimi i njeriut në vetvete është hapi i parë dhe esencial për ndryshimin e shoqërisë, dhe zhvillimin e tij, mirëpo, ai patjetër duhet të jetë pozitiv dhe t'i thërret të tjerët në atë çka është i kënaqur Allahu, Krijues i botëve.

Vëlla!!

Ky ajet nuk flet vetëm për individin, por flet edhe për shoqërinë. Nuk mjafton për ta ndryshuar vetëm veten, e mos të angazhohesh, e mos të përpiqesh për ta ndryshuar shoqërinë, për ta përmirësuar gjendjen e tij me ndihmën e Allahut të Lartmadhëruar.

Shembull:

Si mund t'i mbrosh apo t'i sigurosh fëmijët e tu prej lëndëve narkotike, dhe degjenerimeve tjera të përhapura në shoqëri, derisa shoqëria nuk kujdeset për t'i mbrojtur dhe për t'i siguruar fëmijët e tu?!

Nëse çdo njeri prej neve i lejon dukuritë negative për t'u përhapur dhe asnjëri nuk angazhohet për t'i ndryshuar, një ditë ato dukuri negative do t'na kaplojnë gjithë neve. Zoti na ruajt nga shkatërrimi dhe shkatërrimtarët!

Pse ne nuk jemi të izoluar nga kjo shoqëri dhe nuk mundemi të izolohejmë prej saj.

Shembull:

Shohim prindër të devotshëm, deri në maksimum në fe, mirëpo djemtë e tyre thonë: Ne kemi vepruar gjithçka.

Kjo për arsye se nuk kanë qenë pozitiv në përmirësimin e gjendjes së shoqërisë, në ambientin ku jetojnë.

Ata e kanë lënë që degjenerimi të përhapet në shoqëri dhe nuk kanë urdhëruar në punë të mira, e as nuk kanë ndalua prej punëve të këqija dhe nuk i kanë ndaluar dukuritë negative. Për këtë arsye kanë arritur ato dukuri negative të fëmijët e tyre.

Vërtet Allahu i Lartmadhëruar ka thënë:

“Vërtet Allahu nuk ndryshon diçka në një popull, derisa mos të ndryshojnë ata diçka në vetveten e tyre.”

Erraëd 11

Secili duhet të merr pjesë në ndryshimin e gjendjes së umetit, e jo vetëm një apo disa individë, secili njeri ka përgjegjësi të madhe në ndryshimin e rrethanave dhe dukurive të shëmtuara.

Secili prej nesh duhet të jetë pozitiv në ndryshimin e gjendjes së shoqërisë, derisa ta përmirësojë Allahu gjendjen tonë, po që se vazhdon ndryshimi i plotë i shoqërisë edhe njëqind vite. Secili prej nesh le të përpiqet të veprojë dhe të ndryshojë diçka pozitivisht.

POZITIVITETI NUK ËSHTË THIRRJE ME DHUNË DHE ME NGURRIM

Nuk është pozitiviteti thirrja me dhunë, me nervozë dhe hidhërim. Nuk do të thotë që ai, i cili e quan veten pozitiv të ecë nëpër rrugë për t'u konfrontuar me njerëzit. Ky mendim është i gabuar.

Pozitivitetin e vërtetë e sqaron ajeti fisnik:

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi, me mençuri dhe me këshillat më të volitshme dhe të mira.”

En-Nahl 125

Patjetër pozitiviteti duhet të jetë i plotë dhe i sigurtë, patjetër duhet larguar nga çështjet negative, por në të njëjtën kohë nuk lejohet me thënë: Kjo nuk është çështja ime.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Frikujuni sprovës dhe fitnes, që së paku krimi i atyre, të cilët kanë bërë krime mos t'ju kaplojë juve në veçanti.” El-Enfal 25

A e dini kuptimin e këtij ajeti?

“O ju muslimanë, frikësojuni sprovës, sepse nëse ju kaplon juve, ajo nuk e kaplon vetëm ndonjërin prej jush, por ju kaplon juve në përgjithësi!”

Por si t'i ruhemi kësaj sprove?

Rruga për t'iu ruajtur kësaj sprove është që ne të jemi pozitiv, të urdhërojmë në punë të mira dhe të largojmë prej punëve të këqija, që të mos përhapet e keqja, degjenerimi dhe shkatërrimi.

Transmeton Zejneb bint Xhahsh se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka hy në shtëpi i tronditur duke thënë: “La ilahe il-lallah. Mjerë për arabët nga e keqja, e cila po u afrohet. Atë ditë kur Jeëxhuxhët dhe Meëxhuxhët, dhe të ngjashmit me ta do t'i kenë punët në duart e tyre (dhe i ka bashkuar dy gishtat e mëdhenj të tij).”

Pastaj tregon Zejnebe bint Xhahsh, i kam thënë: O i Dërguar i Allahut, a do të shkatërrohemi derisa në mesin tonë ka të mirë?! I është përgjigj: “Po, nëse përhapet me të madhe e keqja.”

Ajshja r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Në kohët e fundit do të ketë përmytje dhe fundosje në tokë, dhe dënim nga qielli.” Pastaj e kam pyetur: O i Dërguar i Allahut, a do të shkatërrohemi derisa në mesin tonë të ketë të mirë? Është përgjigjur: “Po, nëse përhapet me të madhe e keqja.”

Vëlla!!

Nëse në mesin tonë dominojnë mëkatet, dhe asnjë prej nesh nuk ndërmerr masa shëruese, dhe nuk e marrim pozitivitetin, ne shkatërrohemi edhe pse në mesin tonë ka të mirë.

Është thënë në “Ether”: Allahu e ka urdhëruar Xhibrilin për ta dënuar një fshat me fundosje. Xhibrili i thotë: O Zot, në të është një rob i yti, i cili është në ruku, bën sexhde dhe lutet. Allahu i Lartmadhëruar i thotë: “O Xhibril, prej tij fillo (shkatërrimin – fundosjen).” Xhibrili i thotë: Po si kështu, o Zoti im?!

Allahu i Lartmadhëruar thotë: “Vërtet ai nuk ka marrë asnjëherë kurrfarë hapi për ndryshim të gjendjes pozitive për Mua.”

Vëlla!!

Allahu i Lartmadhëruar e ka urdhëruar Xhibrilin a.s. që të fillojë fundosjen e atij fshati prej këtij robi, derisa veç ishte duke u falur, ishte në sexhde, ishte në ruku, edhe pse ai e adhuronte Allahun, adhurimi i tij ishte i përkufizuar vetëm në veten e tij, ai qëndronte indiferent në ndryshimin e gjendjes pozitivisht, në urdhërim në punë të mira dhe ndalim prej veprave të këqija, ai pajtohej me ta, qëndronte me ta, ishte i kënaqur me ta edhe pse e dinte se ata mëkatonin dhe bënë punë të këqija, ai nuk i urrente dhe nuk i parandalonte nga punët e këqija, nuk i largonte nga mëkatet, nuk i urdhëronte në punë të mira dhe dëgjueshmëri ndaj Krijuesit të tyre, nuk dëshironte ta ndryshojë gjendjen pozitivisht vetëm për Allahun, nuk hidhërohej me tjerët vetëm për Allahun asnjëherë, por përkundrazi i lejonte ata të qëndronin në pozitë të tyre të brishta, në mëkate, degjenerim dhe hipokrizi.

Shiko pra sa i rrezikshën është pasiviteti, negativiteti në shoqëri, në përgjithësi, por edhe në individ në veçanti.

Transmetohet nga Omer bin Hatabi r.a. se ka thënë: “Është e mundur që për pak të shkatërrohet një fshat derisa ai është në ndërtim e sipër!”

E kam pyetur: Po si është e mundur që të shkatërrohet një fshat derisa ai është në ndërtim e sipër? Është përgjigjur: “Kur kriminelët dominojnë dhe janë në pozita më të larta se të mirët.”

Po ashtu transmetohet se ka thënë: “Nëse mëkatari mëkaton fshehtazi, dëmi e kaplon vetëm atë, ndërsa nëse bën mëkate haptazi dhe askush nuk ndërmerr masa për ta ndryshuar atë, dëmi i kaplon që të gjithë.”

“Frikojuni sprovimit, i cili ju kaplon posaçërisht juve për shkak të kriminelëve.”

El-Enfal 23

Transmeton Hudhejfete bin el Jaman se Muhamedi a.s. ka thënë: “Pasha Allahun, që shpirti im është në dorën e Tij, do të urdhëroni në punë të mira dhe do të largoni nga punët e këqija, ose është dro e madhe që Allahu do të ju ndëshkoj me dënim të Tij, e pastaj do të luteni për shpëtim, por nuk do t’ju pranohet lutja.”

Musnedi Imam Ahmedit 22212

Sahih El Xhamiu i Albanit 7070

Vëlla!!

Pozitiviteti është arsye dhe shkak i pranimit të lutjes.

Negativiteti është arsye dhe shkak i mospranimit të lutjes.

Pozitiviteti është arsye dhe shkak i tejkalimit të sprovave dhe dënimeve.

Negativiteti është arsye dhe shkak i dënimeve dhe ndëshkimeve.

Pozitiviteti nuk është thirrje me hidhërim, nervozizëm dhe me dhunë.

Pozitiviteti është urtësi, mençuri, edukatë, sjellje dhe harmoni.

Pozitiviteti është progres dhe zhvillim.

Ai, i cili analizon programin madhështor të Allahut, vëren se ajeti: “Vërtet Allahu nuk ndryshon gjendjen e një populli, derisa ai popull ta ndryshoj gjendjen e tij.”, përfshinë dy çështje esenciale, vëren se janë dy forma të ndryshimit:

1. Ndryshimi i gjendjes nga ana e Allahut të Lartmadhëruar

“Vërtet Allahu nuk ndryshon gjendjen e një populli.”

2. Ndryshimi i gjendjes nga ana e robërve të Tij

“Derisa ai popull ta ndryshoj vetveten e tij.”

Mirëpo, na paraqitet një pyetje shumë e rëndësishme:

Cili ndryshim paraprinë?

Ndryshimi fillon prej ndryshimit të robërve në vetveten e tyre.

Patjetër njerëzit duhet ta ndryshojnë gjendjen e tyre me qëllim që pastaj Allahu ta ndryshojë edhe më mirë. E kjo bëhet duke ndërtuar vetëm me pozitivitet dhe duke u larguar nga negativiteti.

Eja ta ndryshojmë negativitetin në pozitivitet!

Pozitiviteti i së nesërme shpëton vëllezërit tanë në Palestinë.

Pozitiviteti i së nesërme shpëton vëllezërit tanë në Irak.

Shembull tipik për pozitivitet:

Nuëman bin Bashiri r.a. transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë: “Shembulli i atij, i cili i përmbahet ligjeve të Allahut dhe atij, i cili nuk i përmbahet ligjeve të Allahut, është sikurse në një anije udhëtojnë dy grupe njerëzish dhe njëri grup vendoset në katin e parë të anijes, e grupi tjetër në katin e dytë të anijes. Ata të cilët ishin në katin e parë të anijes kur u nevojitet uji duhej të kalonin në katin e dytë. Një ditë ata thanë: Sikur ta kishim qelë një vrimë që ta marrim ujin nga poshtë e mos t’i pengojmë ata lartë. Nëse kati i epërm e lejon një gjë të tillë dhe çka dëshirojnë ata, do të shkatërroheshin të gjithë. Nëse i mbrojnë dhe nuk i lejojnë, shpëtojnë edhe ata, edhe veten e tyre.

Sahihul Buhari 2313

Vështro kuptimin e hadithit!

Praktikuesit e ligjeve të Allahut të Lartmadhëruar janë pozitivët, të cilët urdhërojnë në punë të mira dhe largojnë nga punët e këqija.

Jopraktikuesit e ligjeve të Allahut të Lartmadhëruar janë negativët dhe shkatërruesit. Edhe pse ata, të cilët donin ta bironin anijen, ata kishin qëllim të sinqertë, mirëpo po ta bënë një gjë të tillë dhe nuk do të pengoheshin, anija do të fundosej, e do të fundoseshin pastaj të gjithë udhëtarët së bashku me anijen, do të bëhej fatkeqësi dhe katastrofë, dhe do të mbyteshin.

Kështu ndodh nëse mëkatarët lejohen që të bëjnë mëkate dhe shkatërrime, dhe nuk pengohen e nuk urdhërohen në punë të mira, për të ruajtur kompaktësinë dhe sigurinë e shoqërisë, po mos të ketë urdhërues në punë të mira dhe ndalues nga punët e këqija, do të shkatërrohej shoqëria në përgjithësi.

Pejgamberi s.a.v.s. sjell shembullin, i cili tregon pasojat e negativitetit dhe frytet e pozitivitetit nëse dëshirohet të sigurohet shoqëria me anijen, në të cilën janë udhëtarët, sepse pasojat e shkatërrimit, birimit të anijes janë të menjëhershme dhe secili udhëtar fundoset, ashtu paraqiten pasojat e shkatërrimit të shoqërisë, kur shoqëria largohet prej sistemit dhe programit, të cilin e ka parapa dhe kënaqet Allahu, i shkatërron të gjithë ata, të cilët nuk qëndrojnë kundër atij degjenerimi, shkatërrimi dhe prishjes së programit të Allahut.

Përgjegjësia e negativitetit dhe pasoja bie mbi tërë shoqërinë, po ashtu këto pasoja bien edhe në gjeneratën tjetër nëse vazhdojnë njësoj, nuk largohen prej mëkateve, nuk i dëgjojnë urdhrat e Allahut, nuk urdhërojnë në të mirë, nuk largojnë nga e keqja, dhe nuk e riparojnë gjendjen e shoqërisë.

Allahu i Lartmadhëruar me të drejtë ka thënë:

“Ruajuni sprovave dhe ngatërresave, të cilat nuk i godasin vetëm ata që bëjnë keq (ajo e keqe mund t’ju godas, posaçërisht juve).”

Përgjigja është: Sepse anija i ngjason shoqërisë në tërësi, që të dyja kanë nevojë për balancim dhe barazim, nëse njëra anë pak peshon humb harmonia, peshoja, dhe menjëherë fillon fundosja. Nëse nuk e mbajmë peshojën, balancimin e shoqërisë dhe nuk e ruajmë atë, sikurse ruhet dhe mbahet anija, shkatërrohet e tërë shoqëria. Pra, çështja është se nevojitet angazhim, urtësi dhe mençuri për ta ruajtur peshën dhe balancimin e shoqërisë, e për ta siguruar atë.

SHEMBUJ TË POZITIVISTËVE

Besimtari i familjes së Faraonit

E përshkruan Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an rastin se si Faraoni, Zoti e mallkoftë atë, ka thënë: “Sillmani dhe më lejoni ta vras Musain, e le ta thërrasë Zotin e tij. Pse vërtet unë po frikësohem se do t'ua ndërrojë fenë e juaj, ose do të shkaktojë në tokë tollovi dhe shkatërrim.”

Gafir 26

Besimtari ngrihet me tërë pozitivitetin e tij, i cili deri atëherë e kishte fshehur imanin, ngrihet dhe bën thirrje kundër padrejtësisë së tij, bën thirrje për punë të mira dhe largim nga punët e këqija, nga padrejtësia dhe kriminalistika.

Ai bën thirrje në besim në Allahun e Lartmadhëruar.

Allahu i Lartmadhëruar tregon rrëfimin për të ku thotë:

“Dhe një njeri besimtarë prej familjes së faraonit, i cili e kishte pas imanin e fshehur në veten e tij, tha: A po e vritni njeriun vetëm se thotë: Allahu është Zoti im?! Derisa ai ju ka ardhur (sjellë) juve me argumente prej Zotit tuaj. Nëse rrenë, rrena është për të. Nëse e flet të vërtetën, pjesa e dënimit ju kaplon juve. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë, i cili është shkapërderdhës, rrenacak. O populli im, ju sot e keni në dorë sundimin dhe krenoheni në tokë, por kush mund të na mbrojë neve nga dënimi i Allahut, nëse Ai na dënon?”

Gafir 28 - 29

Ky besimtar pozitiv thotë:

“O populli im! Unë po frikohem për ju, se mund të ju ndodh sikurse u ka ndodhur aleatëve tuaj në ditët e kaluara. Ashtu siç ka qenë (shkatërrimi) i popullit të Nuhut, Adit dhe Themudit, dhe breznive pas tyre. E, Allahu nuk do padrejtësi për robërit e Vet. O populli im, me të vërtet unë po i frikohem dënimit tuaj në Ditën e Thirrjes përfundimtare (Thirrjes së Ditës së Kijametit). Atë ditë kur do të tentoni të ikni prapa, e s'ka për të pas mbrojtës nga dënimi i Allahut. E, atë që Allahu e humbë, për të s'ka më kurrfarë udhërrëfyesi.”

Gafir 30 – 33

Ky besimtar pozitiv bën thirrje dhe thotë:

“O populli im, më pasoni mua, e unë t'ju udhëzoj në rrugë të drejtë. O populli im, jeta e kësaj bote nuk është vetëm se kënaqësi e përkohshme, ndërsa bota tjetër është mu ajo botë e përhershme. Kush ka vepruar keq, ndëshkohet, qoftë mashkull apo femër, por duke qenë besimtar të tillët do të hyjnë në xhenet dhe aty furnizohen pa masë. Dhe, o populli im, ç'është me ju, derisa unë ju thërras në shpëtim, e ju më thirrni për në zjarr? Më thirrni ta mohoj Allahun dhe ta adhuroj dikë tjetër duke i bërë shok, për të cilin nuk di unë asgjë, e unë ju thërras te i Plotfuqishmi, Mëshiruesi i Madh. Padyshim se, atij tek i cili më thirrni ju mua, nuk i takon e adhurimi jonë as në dunja (këtë botë) e as në botën tjetër dhe se e ardhmja jonë është te Allahu, e s'ka dyshim se ata, të cilët largohen prej rrugës së drejtë, ata janë banues të zjarrit.”

Gafir 38 - 44

Cili ka qenë fryti i pozitivitetit të thirrjes në Allahun e Lartmadhëruar?

“Dhe, Allahu e mbrojti atë prej të këqijave dhe trillimeve të tyre e i ithtarët e Faraonit i kaploi dënimi i vrazhdë. Zjarri (të cilit) i nënshtrohen në mëngjes dhe në mbrëmje e kur të arrijë çasti (Dita e Kijametit, u thuhet): Shpini ithtarët e Faraonit në dënimin më të rëndë.”

Gafir 45 – 46

O ti i cili mendon dhe vepron pozitivisht kurrë mos u dobëso dhe kurrë mos e humb shpresën!

Besimtari i suretu Ja Sinë

Allahu i Lartmadhëruar e përshkruan në Librin e Tij fisnik se i ka dërguar në një vend prej vendeve të beni israilëve dy peygamber, mirëpo ata nuk i pranuan, prandaj i përforcon ata dy me të tretin për t'iu ndihmuar në thirrje, mirëpo urrejtja dhe mospranimi vetëm se u shtua edhe më shumë. Atëherë në atë mes paraqitet një besimtar i vendosur, i cili e donte Allahun dhe të Dërguarit e Tij. Ai lajmërohet nga fundi i qytetit me përgjigje pozitive dhe krenarie. Ai, jo vetëm se përgjigjet pozitivisht, por edhe popullin e tij e fton për t'iu përgjigjur ftesës së Allahut, ftesës së peygambereve a.s. dhe dëshmon peygamberin e tyre.

Allahu i Lartmadhëruar tregon:

“Sillu atyre shembullin e banorëve të një vendi kur i kanë ardhur të dërguarit. Pra, kur Ne u dërguam atyre dy (peygamber), e ata (banorë) i përgënjeshtroan që të dy, e Ne i përforcuam me të tretin (peygamber) dhe (që të tre) thanë: Ne jemi të dërguar për te ju. Ata u thanë: Ju nuk jeni asgjë tjetër, përpos njerëz sikurse ne, dhe i Mëshirshmi nuk ju ka shpallur asgjë, por ju vetëm po gënjeni. Ata thanë: Zoti ynë e di se ne jemi me siguri të dërguar për te ju. Dhe obligim i yni është që shpalljen ta përcjellim vetëm haptazi dhe qartë. Ata thanë: Ne parandiejmë rrezik prej jush dhe nëqoftëse nuk tërhiqeni do t'ju mbysim me gurë, dhe me të vërtetë do të përjetoni dënim të dhembshëm nga ana jonë. Ata iu përgjigjën: Fatkeqësia e juaj është te ju! Po vetëm pse po ju tërhiqet vërejtja (ju aq shumë po kundërshtoni). Ju gjithsesi jeni popull që e teproni. Dhe erdh një njeri me vrap nga skaji i qytetit dhe tha: O populli im, dëgjoni dhe pasoni të dërguarit! Pasoni ata, të cilët prej juve nuk kërkojnë kurrfarë shpërblimi! Dhe ata janë në rrugë të drejtë. E përse unë të mos adhuroj Atë, i Cili më krijoi dhe te i Cili do të ktheheni. A të adhuroj zotëra në vend të Atij? E kur i Mëshirshmi dëshiron të më sjell ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i tyre nuk mund të më bëj kurrfarë dobie, dhe ata kurrsesi nuk mund të më shpëtojnë. Unë atëherë do të isha në humbje të qartë. Unë e besoj Zotin tuaj, prandaj dëgjomëni mua.”

Jasinë 13 – 25

Ky besimtar pozitiv nuk i ka thënë popullit të tij: “Nuk është punë e imja t'ju ftuar në të vërtetën, se këta janë peygamberët dhe ata janë përgjegjës në Daëve – Thirrje në Allahun e Lartmadhëruar.

Ai nuk e ka thënë atë fjalë, pse ai ka qenë pozitiv, ka qenë i gatshëm për të marrë përgjegjësi, sepse ai ka shpresua në Allahun dhe botën tjetër. Kjo quhet ‘Pozitivitet’.

Ky besimtar pozitiv, me këshilla të sinqerta dhe thirrje të fortë i thotë popullit të tij: “Vërtet, unë i besova Zotit (tim dhe) tuajin, a po më dëgjoni?!”

Jasinë

Shikoni pra pozitivitetin, ai ka dëshiruar që të gjithë njerëzit ta dëgjojnë dhe ta kuptojnë se ai beson në Allahun, me shpresë se edhe të tjerët do të besojnë si ai. Cili ishte rezultati i pozitivitetit dhe thirrjes në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar?

“I është thënë atij: “Hyr në xhenet.” Ai (klith): O mjerë për popullin tim, sikur ta dinte se Zoti im më fali mua dhe më bëri prej të nderuarve dhe të respektuarve.”

Jasinë 26 – 27

Vëlla!!

A ke mundësi që ti në vendin e punës të marrësh qëndrim dhe t'i thuash shokëve të punës: “Ejani që së bashku ta falim namazin e drekës?”

A ke mundësi që duhanpirësit t'i thuash: “Ju lutem lëreni duhanin, sepse të dëmton shëndetin dhe fiton hidhërimin e Allahut të Lartmadhëruar?”

A ke mundësi që fëmijët tuaj t'i mësosh të jenë pozitiv?

A ke mundësi që prej nesër ta ndryshosh gjendjen tënde?

Hud Hudi i Sulejmanit a.s.

Sulejmani a.s. e kontrolloi numrin e shpendëve, dhe e pa se i mungonte Hud Hudi:

“Dhe bëri një kontroll shpendëve e tha: Çka po ndodh me mua, unë nuk po shoh Hud Hudin, apo nuk është prezent e mungon.”

En-Neml 20

Hud Hudi nuk ishte aty prezent, sepse ai kishte shkuar te një popull, i cili i binte në sexhde diellit e jo Allahut. Atë gjendje të mjerueshme dhe të dhembshme nuk e dëshironte Hud Hudi, por depërton në thellësi për të kontrolluar ata për t’ia treguar Sulejmanit në detaje. Për të pasur argumente më të forta, për t’i sulmuar ato, sepse bënin sexhde diellit e jo Allahut të Lartmadhëruar.

Hud Hudi i mblodhi shënimet, e vështroi terrenin, e vërtetoi situatën. Pastaj kthehet te Sulejmani a.s. për t’ia treguar lajmin, ia tregonte lajmin e pikëlluar, se si ai popull adhuronte tjetër kënd, përpos Allahut të Lartmadhëruar. Ai kishte dëshirë të adhurohej vetëm Allahu i Lartmadhëruar, sepse ishte pozitiv.

Allahu i Lartmadhëruar na tregon këtë ngjarje ku thotë: “E, nuk vonoi shumë, e erdhi ajo (Hud Hudi) dhe tha: Kam marrë vesh atë që nuk e ke ditur ti dhe të kam sjell lajm të sigurt prej sebejit. Kam parë një grua që i sundonte ata dhe që i është dhënë çdo gjë, dhe vërtet ajo kishte një front madhështorë, kam parë se edhe ajo edhe populli i saj adhuronin diellin, e jo Allahun. Atyre ua ka zbukuruar shejtani veprimet e tyre dhe i larguar nga rruga e Allahut, për këtë shkak ata nuk janë të udhëzuar në rrugë të drejtë. (I kishte larguar) Për të mos adhuruar Allahun, që nxjerr në shesh (e di) të fshehtë në qiej e në tokë, dhe që e di atë që fshihni dhe atë që publikoni.”

En-Neml 22 – 26

Paramendo! Hud Hudi me thënë këto fjalë, ndërsa shumë e shumë njerëz nuk kanë mundësi me thënë asnjë fjalë në rrugën e Allahut, nuk kanë mundësi t’i ndihmojnë fesë së Allahut, qoftë në pyetje edhe me një fjalë.

Hud Hudi është pikëlluar dhe është mërëzitur shumë, sepse e ka dashtë Allahun dhe rrugën e Tij.

Hud Hudi është pikëlluar dhe është mërëzitur shumë se ka qenë pozitiv në thirrje në rrugë të Allahut, ajo ka dëshiruar që edhe njerëzit tjerë si ajo, që me pas ndjenja në Allahun dhe Madhërinë e Tij.

A nuk po mësojmë prej Hud Hudit?

A nuk po bëhemi pozitiv si Hud Hudi?

Buburreci i Sulejmanit a.s.

“Deri atëherë kur arritën mbi luginën e buburrecave, një buburrec tha: O ju buburreca, hyni në vendbanimet e juaja që të mos ju shkel Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju hetuar.”

En-Neml 18

Shikoni këtë buburrec të vogël, ndërsa vëreni pozitivitetin e saj dhe frikën e përkujdesjen e saj për shoqërinë e buburrecave, për të mos u dëmtuar dhe për të mos u shkatërruar.

Ka pasur mundësi që ajo të hyjë në vendbanimin e saj pa iu treguar tjerave.

Ka pasur mundësi të mos ia tërheq vërejtjen tjerave.

Mirëpo, ajo ka qenë pozitive, ka pas ndjenja përgjegjësie dhe është përkujdesur për sigurinë dhe qetësinë e shoqërisë së buburrecave.

Vëlla!!

Allahu i Lartmadhëruar në Librin e Tij fisnik na ka sjellë shembuj se si duhet vepruar muslimanët dhe çfarë rruge duhet trasuar ata, na ka sjellë shembullin e pozitivitetit të besimtarit të familjes së Faraonit, besimtarit të suretu Jasinë, sikurse na ka sjellë shembullin e Hud Hudit dhe Buburrecit.

A e patë se sa është i rëndësishëm pozitiviteti në fenë tonë!

POZITIVITETI I HABAB BIN MUNDHIRIT R.A.

Ne luftën e Bedrit, pejgamberi s.a.v.s. shkon deri në fund të puseve të Bedrit, zbret në pusin më të poshtëm prej puseve të Bedrit. Habab bin Mundhiri r.a. i thotë: O i Dërguar i Allahut, në këtë vend ku je dhe ku po thua të pozicionohemi, a është pozicionim të cilin e ka caktuar Allahu, në të cilin vendim as nuk mund të shmangemi, apo është vetëm mendim i strategjisë luftarake? Muhamedi a.s. i thotë: “Është mendim i strategjisë luftarake.”

Hababi r.a. i thotë: Ky pozicionim nuk është i përshtatshëm. Pozicionoj luftëtarët mbi puse, e pastaj aty do të jetë pozicioni më i favorshëm për t’i sulmua nga lart, dhe pas puseve, e pastaj aty te pusi kryesor tubohen njerëzit për të pirë ujë. E derisa armiku zbret poshtë për ujë, ne i sulmojmë nga lart.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ndërron pozicionin dhe ndryshon strategjinë luftarake dhe ngjitet lart aty ku e ka propozuar Hababi r.a.

Vëllezër!

Shikoni pozitivitetin e Hababit r.a., shikoni me çfarë edukate dhe urtësia ka vepruar!

Nuk ka thënë: Kjo nuk është punë e imja.

Nuk ka thënë: Unë jam vetëm një luftëtar prej luftëtarëve, dhe nuk jap mendim as nuk foli për këto çështje. Por, kur e ka kuptuar se pozicionimi i luftëtarëve nuk është çështje vaji, e jep mendimin e tij nga dëshira e tij që muslimanët të fitojnë kundër pabesimtarëve, dhe me ndihmën e Allahut të Lartmadhëruar ata e fituan luftën, pasi që mendimi i Hababit r.a. ishte i drejtë dhe pas konsultimit, u pranua dhe u realizua, dhe ai pozicion ishte shkak i fitores.

POZITIVITETI I NUAJMI BIN MESUDIT R.A.

Ishte lufta e Hendekut. Muslimanët ishin në gjendje kritike, ishin në gjendje katastrofe. Kur te muslimanët, respektivisht, te Muhamedi a.s. shkon Nuajm bin Mesudi r.a. për ta zgatur dorën e ndihmës dhe përkrahjes, Muhamedi a.s. i thotë: “Ti je njëri prej luftëtarëve, trego çka ke në mendje dhe si dëshiron të ndihmosh, se lufta është lajkë dhe tradhti?”

Nuajmi r.a. shkon te aleanca kundër Muhamedit a.s., aty kishte respekt të madh, derisa ata nuk e dinin se ai iu ishte bashkangjitur radhëve të muslimanëve, dhe fillon për të nxitur në mesin e aleancës ndarje, përçarje dhe mosbesim në mes të tyre. Plani i tij pati sukses dhe dinakëria e tij triumfoi, e cila ishte shkak i fitores së muslimanëve në atë luftë.

“Dhe askush nuk e di ushtrinë e Zotit tënd, përpos Tij.”

El Mudethir 31

Kjo pra është pozitivitet, kjo është mbrojtje e të drejtës, kjo është përkrahje e të vërtetës. Kjo është ndjenja e përgjegjësisë.

POZITIVITETI I STUDENTIT TË UNIVERSITET

Gjatë një periudhe kohore prej 70 deri 100 viteve, në Historinë Islame, në një vend arab, ka ndodhur që në Xhami, por edhe në shtëpi faleshin vetëm të varfrit dhe pleqtë, më mirë me thënë; vetëm ata të cilët ishin në prag të vdekjes.

Në mesin e asaj gjendje, në mesin e atyre rrethanave të këqija, ishte një djalosh, i cili falej, çka për djelmoshat e tjerë ishte diçka e habitshme.

Ky djalosh tregon:

Hyra në Universitet dhe pyeta: A nuk ka ndonjë të përcaktuar për falje?!

Iu përgjigjën: Nuk ka në universitet vend për falje. Çka donë të thotë kjo, donë të thotë se vetëm ti falesh!!

Unë vazhdimisht kërkoja dhe insistoja të përcaktohej një vend për falje derisa një ditë prej ditëve më shanë: Në podrum është një vend i zbrazët, ku mund ta shfrytëzosh për falje.

Kur zbrita poshtë në podrum, pashë se aty ishte errët dhe papastërti, ishte si varr, ishte një copëz çilimi edhe ajo copëz ishte e shqyer. Dhe aty e pashë se ishte njëri prej rojtarëve, i cili ishte i varfër e i gjorë dhe, i cili ishte falur aty vetëm.

I thashë atij: Po pse të falemi këtu?

Ai më tha: O biri im, për mos me qesh me neve pse falemi!

I thashë atij: Mirëpo unë nuk dua të falem nën tokë, unë do të falem mbi tokë.

Djaloshi del prej bodrumit dhe në mesin e studentëve – vazhdon ngjarjen:

E thirra Ezanin, Ikametin dhe fillova të falem. Studentët ndaleshin dhe e shikonin duke u falur. Kështu ai vepronte për çdo ditë, në ditën e katërt, në namaz i bashkëngjitet edhe rojtari, i cili falej vetëm në bodrum. Pastaj atij iu bashkua një rresht (një saf), me ta filloi të falej edhe një profesor, pastaj iu bashkuan të tjerët dhe u bënë shumë rreshta (safa).

Tregon ky djalosh: Rektori i Universitetit më ftoi në zyrën e tij dhe më tha: Për t'u falur kështu nuk është në rregull, por do ta ndërtojmë një Mesxhidi në oborr të Universitetit, ku do të falemi.

U ndërtua Mesxhidi i parë në Universitet, pastaj filluan të ndërtoheshin mesxhidet në universitete dhe fakultete tjera.

Ndërsa, ky djaloshi të ketë fitim dhe shpërblimin e përgjithmonshëm, shpërblimin deri në Ditën e Kijametit, shpërblimin, vlerën e të cilit nuk e di askush tjetër pos Allahut të Lartmadhëruar.

Vëllezër!!

Si është e mundur që, mëkatarët e të këqijtë, kriminelët, shkatërrimin e tyre e ngritin lart që t'u bashkëngjiten atyre të këqijtë, ndërsa të mirët turpërohen me ngritë flamurin dhe simbolin e së mirës, që t'u bashkëngjiten të mirët dhe të pastrit.

Në fund

Dhe fjala e fundit e jona:

Falënderojmë Allahun, Krijuesin e gjithë botëve.